

**KUSHTET E PERGJITHSHME TE KONTRATES**  
**PER**  
**SIGURIMIN NGA BRESHERI**

**Dispozita te pergjithshme**

1. Kushtet e pergjithshme te Kontrates per Sigurimin nga Bresheri , ketu me poshte do te quhen shkurtimisht “ **Kushtet e Sigurimit**”.

INSIG SHA, ketu me poshte do te quhet shkurtimisht “ **Siguruesi** “. Personi fizik ose juridik , interesi pasuror I te cilit do te mbulohet per Sigurimin nga Bresheri , ketu me poshte do te quhet shkurtimisht “ **I Siguruari** “.

**Objekti I Sigurimit**

2. Siguruesi ofron mbulim ne sigurim per te gjithe llojet e kulturave bujqesore. Siperfaqja e siguruar per secilen culture duhet te jete jo me e vogel se 1 dnyum (1000m<sup>2</sup>).
3. Sigurimi mbulon humbjet dhe demtimet sasiore te prodhimit kryesor.

**Rreziket e Sigurimit**

4. Rreziku I sigurimit eshte ngjarje e papritur dhe e paparashikuar. Siguruesi mbulon rrezikun e sigurimit:

- Bresheri

Me bresher kuptohen reshjet qe formohen nga pikat e shiut te ngrira si akull ne ajer dhe qe bien ne forme kokrrash.

Demtimet qe u shkaktohen kulturave bujqesore nga bresheri jane te ndryshme: goditje e plote ose pjesore e kallirit, copetim ose thyerje e kashtes , carje ne mes e bimes , keputje e plote ose e pjeseshme e gjethes, cpuarja e gjethes, keputja dhe copetimi I filizave, goditja e luleve dhe e frutave , plagosja e frutave, trupit te bimeve dhe demtime te tjera te saj.

## Rreziqe shtese te sigurimit

5. Siguruesi mbulon edhe rreziqet shtese te sigurimit si me poshte :

### **1- Stuhia.**

Me stuhi do te kuptohet era e vrullshme dhe e shpejte me shpejtesi mbi 60 km/ ore qe mund te shoqerohet me reshje.

Stuhia I shkakton bimeve demtime mekanike ne formen e thyerjes se kallinjve , fleteve , por shpesh ai ne vende te larta shkakton fryerjen e pjeses se sipërme te sipërfaqes dhe zbulimin e sistemit te rrenjeve , kurse ne vendet e uleta mbushjen e bimeve me pjese te vogla te sipërfaqes.

### **2- Shtrengata.**

Me shtrengate kuptohet shiu I rrembyer shoqeruar me ere te fuqishme. Shtrengata shtrin perdhe te mbjellat e rritura, rrezon frutat , thyen degët e pemeve ose I rrezon pemet perdhe, mbulon te mbjellat me rere dhe me toke, shkul nga rrenjet bimët e njoma dhe te paforcuar.

### **3- Permbytja.**

Me permbytje kuptohet mbulimi teresisht I tokes nga ujrät si rezultati vershimit te lumenjve ose perrenjve. Cdo permbytje shkaktohet ne ndonje rezultat tjetër , perben nje rrezik per te cilin Siguruese nuk mban pergjegjesi.

Nga permbytjet ndodhin demtime pulla-pulla neper vende te ndryshme ne bimët e mbetura gjalle. Bimët e ptishura kane ngjyre te verdhe te zbehte.

Rreziqet shtese te sigurimit te sipërpermendura, do te mbulohen vetem ne qofte se permenden shprehimisht ne policen e sigurimit dhe eshte paguar primi shtese I tyre.

## Mbulimi ne sigurim

6. Ky sigurim mbulon prodhimin bujqesor te siguruar vetem per nje cikël prodhimi te kulturave te para. Mbulimi ne sigurim fillon pas lidhjes se kontrates se sigurimit por jo me pare se:

- 1- Nga momenti I mbjelljes , per kulturat qe mbillen me fidane;
- 2- Nga momenti I celjes se luleve, per agrumet, per ullinjtë dhe peme te tjera frutore;
- 3- Nga momenti I celjes se sythave , per vreshtat;
- 4- Nga momenti I daljes ne sipërfaqe per kulturat e tjera.

## Perjashtimet

9. Perjashtohen nga mbulimi ne sigurim rastet kur:

- a. Demet shkaktohen per faj ose pakujdesi te rende te te siguruarit, perfaqesuesit te tij ose nje personi te familjes se tij;
- b. I siguruari nuk ka zbatuar masat agroteknike;

- c. Demet shkaktohen nga lufta , invazioni , veprime te armikut te jashtem , veprimet luftarake ( pavaresisht nese eshte shpallur lufta ose jo ), lufta civile, rebelimi, kryengritja, trazirat, grevat;
- d. Demet shkaktohen me urdhera te autoriteteve shteterore;
- e. Demet shkaktohet nga shperthimet ose rrezatimet berthamore.

INSIG SHA